

**MARRËVESHJE E TRANSFERIMIT TË KAPITALIT TË SHOQËRISË ABA BLUE
BORGO SH.P.K.**

ndërmjet

Z. Bashkim Ulaj

dhe

Znj. Borena Çelaj

Tiranë, më 6 / 11 /2025

TABELA E LËNDËS

KREU I. PËRKUFIZIMET DHE INTERPRETIMI.....	3
NENI 1.01 PËRKUFIZIMET	3
NENI 1.02 INTERPRETIMI.....	4
KREU II. TË PËRGJITHSHME.....	5
NENI 2.01 QËLLIMI I MARRËVESHJES.....	5
NENI 2.02 BAZA LIGJORE.....	5
KREU III. OBJEKTI I MARRËVESHJES.....	5
NENI 3.01 TRANSFERIMI I KAPITALIT	5
NENI 3.02 KALIMI I TITULLIT TË PRONËSISË	5
NENI 3.03 PASOJAT E PËRFUNDIMIT TË TRANSFERIMIT	5
KREU IV. DEKLARIMET, GARANCITË DHE PREMTIMET	5
NENI 4.01 DEKLARIMET DHE GARANCITË E PALËVE	5
NENI 4.02 PREMTIMET E PALËVE.....	6
KREU V. HYRJA NË FUQI DHE ZGJIDHJA E MARRËVESHJES.....	6
NENI 5.01 HYRJA NË FUQI	6
NENI 5.02 ZGJIDHJA E MARRËVESHJES	6
KREU VI. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE.....	7
NENI 6.01 PËRPJEKJET PËR MIRËKUPTIM	7
NENI 6.02 GJYKATA KOMPETENTE.....	7
NENI 6.03 LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM	7
KREU VII. TË NDRYSHME.....	7
NENI 7.01 NJOFTIMET	7
NENI 7.02 HEQJA DORË	7
NENI 7.03 VEÇUESHMËRIA	8
NENI 7.04 MARRËVESHJA E PLOTË.....	8
NENI 7.05 NDRYSHIMET	8
NENI 7.06 SHPENZIMET.....	8
NENI 7.07 TË KUPTUARIT E DOKUMENTEVE DHE DISPOZITAVE.....	8
NENI 7.08 KOPJET E NJËJTA.....	8

MARRËVESHJE

Kjo MARRËVESHJE TRANSFERIMI KAPITALI (në vijim "**Marrëveshja**") nënshkruhet sot më datë 6.11.25 ("**Data e Nënshkrimit**") nga dhe ndërmjet **Z. Bashkim Ulaj**, i biri i Isës, i lindur më 15.03.1963, në Mamurras, Kruje dhe banues në adresen Rruga "Mustafa Matohiti", Nd. P 7; H Shk. 2; Tirane, i identifikuar nëpërmjet Letërnjoftimit ID me nr. **036427423**, me nr. personal **G30315336U**, madhor me zotësi juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar, (në vijim "**Transferuesi**"), si dhe **Zuj. Borena Çelaj**, e bija e Isuf-it, e lindur më 09.08.2001, në Tiranë, dhe banuese në adresen Rruga "Mustafa Matohiti", Nd. 7; H 1; Tirane, e identifikuar nëpërmjet Letërnjoftimit ID me nr. numër personal **K15809065L**, madhore me zotësi juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar (në vijim "**Përfituesi**").

Transferuesi dhe Përfituesi referohen në këtë Marrëveshje si "**Pala**" dhe së bashku "**Palët**" sipas varianteve të tyre gjuhësore në njëjës ose në shumës, siç mund t'a kërkojë herë pas here konteksti i kësaj Marrëveshje.

MEQENËSE, Transferuesi zotëron 19 % (nëntëmbëdhjetë përqind) të Kapitalit të regjistruar të Shoqërisë "**ABA BLUE BORGO**" Sh.p.k., në vlerën 19,000 (nëntëmbëdhjetë mijë) Lekë, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me zyrë qendrore në Rruga "Papa Gjon Pali II", Ndërtesa nr. 12 "ABA Business Center", kati I 7-te teknik, Njesia Administrative nr.2, Tiranë, Shqipëri. Nr. Pasurie 7/52-N9 e llojit "Njësi", regjistruar në ASHK, Zona Kadastrale 8160, vol. 36, fq.212. 1010, Tiranë, identifikuar me NUIS **M41317061B** ("**Shoqëria**").

MEQENËSE, Transferuesi dhe Përfituesi dëshirojnë të realizohet transferimi i një pjese të Kapitalit nga Transferuesi tek Përfituesi, e cila përfaqëson 15.79 % të pjesëmarrjes që mban Transferuesi në Shoqëri, ose 3 % të Kapitalit të regjistruar të Shoqërisë ("**Kuota**")

MEQENËSE, Palët dëshirojnë të specifikojnë në këtë Marrëveshje, mes të tjerash, të drejtat, detyrimet dhe kushtet e marrëdhënies juridike mes tyre;

ATËHERË, bazuar në të drejtat, detyrimet, garancitë dhe premtimet reciproke që përmbahen këtu si dhe bazuar në Legjislacionin e Zbatueshëm, Palët bien dakord si vijon:

KREU I. PËRKUFIZIMET DHE INTERPRETIMI

Neni 1.01 Përkufizimet

Fjalët e përdorura në këtë Marrëveshje me gërma kapitale do të kenë kuptimin si më poshtë:

"**Autoriteti Kontraktor**" ka kuptimin që i është dhënë në preambulën e kësaj Marrëveshje.

"**Data e Nënshkrimit**" ka kuptimin që i është dhënë në preambulën e kësaj Marrëveshje.

"**Ditë Pune**" do të thotë dita në të cilën Banka e Shqipërisë është e hapur për punë, përjashtuar të shtunën, të dielën dhe festat zyrtare.

"**Entitet Qeveritar**" do të thotë (i) Kuvendi, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, çdo ministri, departament, ose nëndarje e tyre; dhe (ii) çdo Person tjetër, gjykatë, agjenci apo autoritet nën

kontrollin e drejtpërdrejtë ose jo të Republikës së Shqipërisë, çdo ministrie, departamenti, apo nëndarje e tyre politike, që ka juridiksionin mbi Palët sipas Legjislacionit të Zbatueshëm.

„Kapitali” do të thotë 100 % e Kapitalit të regjistruar të Shoqërisë në vlerën 100,000 (njqind mije) Leke.

„Kuota” do të thotë 15.79 % të pjesëmarrjes që mban Transferuesi në Shoqëri, ose 3 % e Kapitalit të Shoqërisë, në vlerën 3,000 (tre mije) Leke.

„Legjislacioni i Zbatueshëm” do të thotë çdo akt i Entiteteve Qeveritare, përfshirë, ligj, akt nënligjor, urdhëresë, dekret, rregullore, udhëzim, licensë, autorizim ose aprovim tjetër nga një Entitet Qeveritar që ka juridiksionin dhe autoritetin e duhur mbi Palët, siç mund të ndryshohen herë pas here.

„Marrëveshja” ka kuptimin e dhënë në preambulën e kësaj Marrëveshje.

„Mosmarrëveshje” ka kuptimin që i është dhënë në Neni 6.01 (*Përpyjeket për Mirëkuptim*).

„Palë” ka kuptimin e parashikuar në preambulën e kësaj Marrëveshje.

„Person” do të thotë çdo individ, person fizik, shoqëri tregtare, ortakëri e çdo lloj forme organizimi e parashikuar nga Legjislacioni i Zbatueshëm ose ai i një vendi specifik, përfshirë Entitetet Qeveritare.

„Përfituesi” ka kuptimin që i është dhënë në preambulën e kësaj Marrëveshje.

„Pretendim” do të thotë çdo ankesë, padi, pretendim, kërkesë për dëmshpërblim, në gjykatë, gjykatë arbitrazhi, Entitet Qeveritar apo në çdo institucion a organizëm që merr vendime të ngjashme dhe që ka juridiksionin mbi Palët.

„Transferuesi” ka kuptimin që i është dhënë në preambulën e kësaj Marrëveshje.

Neni 1.02 Interpretimi

(a) Kontrata si e Tërë. Çdo e drejtë, detyrim, apo kusht i përshkruar në këtë Marrëveshje duhet të interpretohet në kontekstin e Marrëveshjes të marrë si e tërë dhe duke marrë në konsideratë qëllimet që nxitën Palët për të hyrë në këtë Marrëveshje.

(b) Titujt, Krerët, Nenet, Paragrafët: Titujt e kërësve, neneve, paragrafëve, nënparagrafëve që përmban kjo Marrëveshje si dhe ato që janë në tabelën e lëndës janë vetëm për referencë dhe nuk do të ndikojnë në asnjë mënyrë në kuptimin apo interpretimin e kësaj Marrëveshje.

(c) Shtojcat. Të gjitha anekset dhe shtojcat bashkëngjitur apo referuar, janë të inkuorpuara dhe janë pjesë integrale e kësaj Marrëveshje. Nëse një fjalë e përdorur në ndonjë aneks apo shtojcë fillon me gërmë kapitale por nuk është e përkufizuar në këtë aneks apo shtojcë, do të ketë kuptimin e përkufizuar në këtë Marrëveshje. Kur në tekstin e kësaj Marrëveshje ka referencë për një kre, nen, paragraf, nënparagraf, aneks, shtojcë, të tilla referencë lidhen me kreun, nenin, paragrafin, nënparagrafin, Shtojcat apo shtojcën e kësaj Marrëveshje, përveçse kur përcaktohet ndryshe.

(d) Interpretimet Gramatikore. Përveçse në rastet kur thuhet shprehimisht ndryshe, në këtë Marrëveshje:

- (i) Fjalët e përdorura në numrin njëjës përfshijnë edhe ato të përdorura në numrin shumës;
- (ii) Fjalët e përdorura në një rasë apo gjini përfshijnë, sipas kontekstit, edhe rasat dhe gjinitë e tjera;
- (iii) Nëse një fjalë është e përkufizuar, edhe format e tjera gramatikore do të kenë kuptimin përkatës; dhe
- (iv) Fjala “përfshin”, do të thotë “përfshin, pa u kufizuar”, pavarësisht nëse ky togfjalësh e pason ose jo.

KREU II. TË PËRGJITHSHME

Neni 2.01 Qëllimi i Marrëveshjes

Qëllimi i kësaj Marrëveshje është përcaktimi dhe dokumentimi i saktë i marrëveshjeve, të drejtave, detyrimeve, garancive dhe premtimeve të Palëve me qëllim transferimin e Kuotës tek Përfituesi.

Neni 2.02 Baza Ligjore

Kjo Marrëveshje bazohet ndër të tjera në Nenet 659 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë i ndryshuar, në Ligjin nr. 8438/1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar, në Ligjin nr. 990/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, si dhe në Legjislacionin e Zbatueshëm.

KREU III. OBJEKTI I MARRËVESHJES

Neni 3.01 Transferimi i Kapitalit

(a) Zëvendësimi. Objekti i kësaj Marrëveshjeje është transferimi i Kuotes që perfaqeson 3 % të Kapitalit nga Transferuesi tek Përfituesi për qëllime të riorganizimit të Transferuesit në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 8438/1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar.

(b) Shpërblym. Transferimi i Kuotës prej 15.79 % të pjesëmarrjes që mban Transferuesi në Shoqëri, ose 3 % e Kapitalit të Shoqërisë nga Transferuesi tek Përfituesi, do të kryhet kundrejt vlerës prej 3,000 (tre mijë) Leke, shumë e cila do të paguhet nga Përfituesi pas Dates së Nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3.02 Kalimi i Titullit të Pronësisë

Palët bien dakord se kalimi i titullit të pronësisë mbi Kuotën që perfaqeson 3% të Kapitalit nga Transferuesi tek Përfituesi do të ndodhë nga Data e Nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje. Palët bien dakord se nga Data e Nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, secila prej Palëve ka të drejtë të depozitojë këtë Marrëveshjeje për të regjistruar ndryshimin e pronësisë së Kuotës në emër të Përfituesit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

Neni 3.03 Pasojat e Përfundimit të Transferimit

Duke filluar nga Data e Nënshkrimit, Përfituesi do të jetë pronar me të drejta të plota të 3 % të Kapitalit dhe se do të ushtrojë të gjitha të drejtat që burojnë nga 3 % e Kapitalit.

KREU IV. DEKLARIMET, GARANCITË DHE PREMTIMET

Neni 4.01 Deklarimet dhe Garancitë e Palëve

(a) Legjitimiteti. Palët kanë përmbushur detyrimet ligjore në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm.

(b) Autoriteti; Nënshkrimi dhe Dorëzimi; Zbatimi. Secila nga Palët ka tagër dhe autoritet të plotë juridik për të nënshkruar këtë Marrëveshje dhe për të kryer transaksionet e përmendura në të. Nënshkrimi i Marrëveshjes, dorëzimi i Marrëveshjes së nënshkruar Palës tjetër si dhe kryerja e transaksioneve të përmendura në këtë Marrëveshje janë të autorizuar në mënyrë të rregullt nga të gjitha aktet e nevojshme të secilës prej Palëve. Secila nga Palët e ka nënshkruar dhe ja ka dorëzuar Palës tjetër këtë Marrëveshje të nënshkruar sipas rregullave dhe kjo Marrëveshje përbën detyrim të vlefshëm, të ligjshëm, të detyrueshëm dhe të zbatueshëm të secilës Palë në përputhje me kushtet dhe detyrimet që përmban Marrëveshja dhe Legjislacioni i Zbatueshëm.

(c) Vërtetësia e Deklarimeve. As kjo Marrëveshje, as ndonjë deklaratë dhe as ndonjë dokument i shkruar, i përgatitur dhe i paraqitur, ose që duhet përgatitur dhe paraqitur nga secila nga Palët, sipas kësaj Marrëveshje ose në lidhje me transaksionet si pasojë e saj, nuk përmban ndonjë deklaram, apo nuk lë pa përmendur fakte materiale të domosdoshme, prania ose mungesa e të cilave do t'i bënte këto deklarata, raporte apo dokumenta të pasakta, të pavërteta apo të paefektshme.

(d) Nuk ka dijeni për Deklarata të Pasakta. Secila nga Palët nuk ka dijeni që ndonjë nga deklaramet, garancitë apo premtimet e bëra nga vetë Pala apo nga Pala tjetër në këtë Marrëveshje mund të mos jenë të vërteta apo të sakta.

(e) Mungesa e Shkakut që Sjell Pavlefshmërinë. Secila nga Palët nuk ka dijeni për ndonjë shkak që mund të sjellë pavlefshmërinë e Marrëveshjes apo ndonjë neni të saj.

(f) Procedura Gjyqësore. Secila nga Palët deklaron se në dijeninë e saj nuk ka asnjë Gjykim, veprim, procedurë apo hetim në ndonjë gjykatë apo institucion tjetër (i) që mund ta ndalojë atë të nëshkruajë këtë Marrëveshje, (ii) që ka qëllim ndalimin e kryerjes së veprimeve që janë objekt i kësaj Marrëveshje, ose (iii) që mund të ndalojë apo që mund të ndikojë thelbësisht dhe negativisht në përmbushjen e detyrimeve të një Pale sipas kësaj Marrëveshje, ose vlefshmërinë dhe zbatueshmërinë e saj.

Neni 4.02 Premtimet e Palëve

(a) Bashkëpunimi. Palët premtojnë dhe marrin përsipër që të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën gjatë gjithë kohës në mirëbesim, dhe të kryejnë të gjitha veprimet dhe të ndërmarrin të gjitha hapat e mundshëm dhe që janë të nevojshëm për, ose lidhur me, vënien në zbatim dhe plotësimin e parashikimeve të kësaj Marrëveshje, përfshirë, pa u kufizuar, të nënshkruajnë dokumente të tjera të nevojshme për të kryer e dhënë fuqi të plotë parashikimeve të kësaj Marrëveshje dhe qëllimeve të Palëve të pasqyruara në të.

(b) Veprime të Arsyeshme. Palët premtojnë dhe marrin përsipër që do të veprojnë gjithmonë në mënyrë të arsyeshme dhe në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm gjatë ushtrimit të drejtave apo diskrecionit që u është dhënë nga kjo Marrëveshje.

KREU V. HYRJA NË FUQI DHE ZGJIDHJA E MARRËVESHJES

Neni 5.01 Hyrja në Fuqi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në Datën e Nënshkrimit.

Neni 5.02 Zgjidhja e Marrëveshjes

(a) Zgjidhja e Marrëveshjes. Kjo Marrëveshje nuk mund të zgjidhet në mënyrë të njënashme nga asnjëra prej Palëve. Kjo Marrëveshje mund të zgjidhet vetëm me pranimin me shkrim të Palëve.

(b) Pasojat e Zgjidhjes së Marrëveshjes. Pasojat e zgjidhjes së Marrëveshjes do të rregullohen në marrëveshjen e zgjidhjes së Marrëveshjes mes palëve siç është parashikuar në paragrafin (a) të këtij neni.

KREU VI. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 6.01 Përpyjekjet për Mirëkuptim

Palët bien dakord se do të përpiqen të zgjidhin me mirëkuptim, çdo ankesë, debat, apo mosmarrëveshje ("Mosmarrëveshje") që vjen si pasojë ose lidhet me këtë Marrëveshje.

Neni 6.02 Gjykata Kompetente

Në rast se Palët nuk arrijnë t'i zgjidhin Mosmarrëveshjet me mirëkuptim, Gjykata kompetente për zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Palëve, do të jetë Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Neni 6.03 Legjislacioni i Zbatueshëm

Kjo Marrëveshje është hartuar dhe do të interpretohet në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm.

KREU VII. TË NDRYSHME.

Neni 7.01 Njoftimet

(a) Metoda e Njoftimit. Njoftimet dhe çdo lloj tjetër komunikimi në lidhje me këtë Marrëveshje do të jetë me shkrim dhe në gjuhën shqipe dhe duhet të bëhet në përputhje me këtë nen. Njoftimi do të bëhet: (i) duke e dorëzuar personalisht, me kundërfirmë; ose (ii) dërguar me postë të parapaguar me konfirmim dorëzimi nga Pala marrëse në adresën e përcaktuar në këtë Marrëveshje, apo ndonjë adresë tjetër të specifikuar nga Pala përkatëse.

(b) Koha e Njoftimit. Çdo njoftim, i dërguar sipas mënyrave të mësipërme do të konsiderohet si i dorëzuar sipas rregullave dhe në kohën e specifikuar si më poshtë:

- (1) Në rastin e dërgimit dorazi, kur dorëzimi kryhet te përfaqësuesit e Palës marrëse gjatë Ditës së Punës dhe dorëzimi është pranuar me shkrim nga Pala;
- (2) Në rastin e njoftimit me postë të parapaguar, në mungesë të provave që njoftimi është marrë më parë, njoftimi konsiderohet i dhënë, nëse është dërguar me postë, 5 (pesë) Ditë Pune pas postimit;

(c) Ndryshimi i Adresës ose Emrit. Secila Palë do ta njoftojë menjëherë Palën tjetër të kësaj Marrëveshje, në rast ndryshimi të të dhënave të specifikuara në këtë nen.

Neni 7.02 Heqja Dorë

Asnjë mospërmbushje ose vonesë në përmbushjen e detyrimit nga secila Palë në ushtrimin e ndonjë të drejte apo përmbushjen e ndonjë detyrimi të parashikuar në këtë Marrëveshje nuk mund të konsiderohet

si heqje dorë. Heqja dorë nga cilado Palë nga ndonjë e drejtë apo detyrim i kësaj Marrëveshje nuk do të ketë asnjë efekt në rast se nuk është bërë me shkrim.

Neni 7.03 Veçueshmëria

Nëse ndonjë dispozitë e kësaj Marrëveshje konsiderohet e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme nga një Entitet Qeveritar, kësaj dispozite nuk do t'i jepet asnjë efekt dhe do të konsiderohet se nuk është përfshirë në këtë Marrëveshje, por pa shfuqizuar dispozitat e tjera të Marrëveshjes. Dispozita e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme do të zëvendësohet me një dispozitë të ligjshme, të përshtatshme, të vlefshme, të zbatueshme dhe që i afrohet sa më shumë synimit dhe qëllimit të dispozitës së paligjshme, të pavlefshme ose të pazbatueshme.

Neni 7.04 Marrëveshja e Plotë

Kjo Marrëveshje përbën marrëveshjen e plotë midis Palëve në lidhje me objektin e kësaj Marrëveshje. Nuk ka asnjë kusht, detyrim, ose marrëveshje të tjera mes Palëve në lidhje me objektin e kësaj Marrëveshje (me gojë ose me shkrim, të shprehur, nënkuptuar ose të çfarëdo forme), përveç asaj që është përcaktuar në mënyrë specifike në këtë Marrëveshje.

Neni 7.05 Ndryshimet

Ndryshimet e kësaj Marrëveshje, përfshirë dhe Aneksat e saj, janë të vlefshme vetëm nëse bëhen me shkrim dhe nënshkruhen nga Palët.

Neni 7.06 Shpenzimet

Përveç kur është shprehur specifikisht ndryshe në këtë Marrëveshje, secila Palë është përgjegjëse për çdo shpenzim në lidhje me negocimin apo nënshkrimin e kësaj Marrëveshje dhe detyrimet që rrjedhin prej saj.

Neni 7.07 Të Kuptuarit e Dokumenteve dhe Dispozitave

Palët pranojnë dhe janë dakord se ato i kanë lexuar dhe kuptuar kushtet, detyrimet dhe të drejtat e lindura nga kjo Marrëveshje dhe se ata kanë pasur mundësinë të këshillohen me juristë sipas zgjedhjes së tyre.

Neni 7.08 Kopjet e Njëjta

Kjo Marrëveshje mund të nënshkruhet në disa kopje, dhe çdonjëra prej të cilave kur është e nënshkruar dhe dorëzuar nga të dy Palët në mënyrë të rregullt, do të konsiderohet si origjinale dhe të gjitha së bashku do të përbëjnë një dokument të vetëm.

PALËT

TRANSFERUESI

Z. Bashkim Ulaj

PËRFITUESI

Znj. Borena Çelaj